

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Edi Rama mund ta turpërojë edhe më shumë Shqipërinë
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/edi-rama-mund-ta-turperroje-edhe-me-shume-shqiperine-i474913
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:08:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 14:38:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cd60efd7774cdef5ddd7c1483a0b5f78ffde6c05924648f439736728fb6653e2
TEKSTI	0d05ef5e7f90a269780d8e9115baee28b002f006a9adf438ee21e10cb1a14d62
PAMJA	c462c97f68fdeffd0bd1f84d888f9bef3f9b543797d1d439fb0fbc7349b9cb51

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9833edab62997f8b4639dde77786740e7cd9f6eabb5442dc23b6fcb4a7dc52d8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9833edab62997f8b4639dde77786740e7cd9f6eabb5442dc23b6fcb4a7dc52d8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Edi Rama mund ta turpërojë edhe më shumë Shqipërinë



22 Shtator 2026, 16:38, Aktualitet CNA



Nënkryetari i PD-së, Belind Këlliçi ka bërë një postim në rrjetet sociale ku shprehet se kryeministri Edi Rama mund ta turpërojë më shumë Shqipërinë duke u ngjitur në foltoren e OKB-së, si "kreu i një narkoshteti".

Këlliçi shkruan se Rama është i vetmi përfaqësues nga të gjithë liderët që ndodhen në New York që e ka shefin e shërbimit sekret në arrest për favorizim krimi dhe nxjerrje informacioni dhe që sipas tij ka gjithë strukturën e sigurisë kombëtare të kompromentuar.

Ai shton më tej se Rama nuk përfaqëson asgjë kombëtare dhe asnjë qytetar. Këlliçi shkruan se kriza është e madhe dhe se duhet zgjidhje e menjëhershme politike.

Reagimi i plotë:

Edi Rama mund ta turpërojë edhe më shumë Shqipërinë, duke u ngjitur në foltoren e OKB si kreu i një Narkoshteti!

Edi Rama mund ta turpërojë Shqipërinë edhe më shumë nga sa ka bërë deri tani, duke folur përshembull të premtën në sallën e OKB, te foltorja ku ngjiten gjithë kryeministrat apo krerët e shtetit të vendeve anëtarëve.

Ai është që tani i vetmi përfaqësues nga gjithë liderët e botës që gjenden në New York, që e ka shefin e shërbimit sekret në arrest për favorizim krimi dhe nxjerrje informacioni, që ka bashkëpunëtorët më të ngushtë nën masa dhe akuza për grup të strukturuar kriminal, që ka zëvendësen e tij për shumë vite nën akuzë për fshehje pasurie, korrupsion dhe pastrim parash, që ka gjithë strukturën e sigurisë kombëtare të kompromentuar.

Dhe imagjinoi që ky njeri, do të ngjitet të premten në podiumin e OKB dhe do të flasë patjetër për sigurinë.

Ndryshe nga liderët e tjerë që gjenden në atë asamble, Edi Rama është i vetmi që përfaqëson një organizatë kriminale. Ai nuk përfaqëson asgjë shqiptare, asgjë kombëtare, asnjë qytetar më.


Dhe është turp për Shqipërinë që shefi i Gysit të kimit, i Belës së vilave, i Vlorës së sekreteve të shitura, i Prodës së policëve të implikuar, i Veliajt të 5D, të ngjitet në foltoren më të lartë të botës.

Por Edi Rama nuk ka turp. Derisa nuk ka turp t'i organizojë gjithë këto afera e krime, s'ka si të skuqet kur ato merren vesh.

Si dhe herë të tjera, ai do të luajë këto ditë kartën e patriotizmit e do të derdhë lotët e hipokrizisë për luftëtarët e Kosovës.

Por këto nuk do ta ndihmojnë aspak. Kreditet e tij janë një zero absolute. Dhe e vetmja lëvizje që mund të bëjë ky tradhtar i republikës është të japë dorëheqjen sapo të shkelë në Shqipëri.

Ky vend nuk mund ta mbajë më asnjë minutë në krye një njeri kaq të inkriminuar. Kriza është e madhe. Duhet zgjidhje e menjëhershme politike.
/CNA





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Gazetari: Vlora Hyseni e ka mbyllur ciklin e karrierës, sinops për dokumentar

Industria e gjobëvënies/ Nikolin Jaka: Bizneset përballen me humbje serioze financiare

Mbledhja e FBINAA-së/ Ambasada e SHBA-së: Qëllimi i vetëm është zbatimi i fortë i ligjit

Sekuestrohet hoteli 5-katësh pa leje në Ksamil, 1 shtetas në arrest shtëpie

Sulmet e mediave anonime/ Dhoma e Tregtisë: Të zbatohen masat që mbrojnë biznesin

Masa e sigurisë për Vlora Hysenin/ Rama e liron nga detyra si kryetare e SHISH

Gjobëvënia nga mediat dhe portalet anonime/ Nikolin Jaka: Po sulmohen dhe dëmtohen qëllimisht bizneset

Projektligji i ri krijon hapësirën e posaçme ligjore për emetimin e obligacioneve të mbuluara

Kikia: Ngjarje fatale, zyrtarët e inkriminuar kanë ngrënë kokën e shtetit

Masa ndaj Hysenit/ Xhafaj, si Spiropali: Ndodh rëndom në botë

Operacioni i SPAK-ut/ Kontrolle në kompleksin e vilave në Shkozë

Vlora Hyseni dhe Ilir Proda në rrjetën e SPAK-ut/ Prokuroria e Posaçme jep detaje

Apeli i Posaçëm lë në burg Ergys Agasin dhe ish-efektivin që e shoqëronte

“Rama e Agasi takoheshin në Durrës”/ Kush është Embro Sulejmani?

Vlora Hyseni drekonte e darkonte me Agasin në mes të Tiranës

Prapaskenat/ Vlora Hyseni, nga shkarkimi tek Inteligjenca e Kosovës, te ardhja në krye të SHISH-it

Opozita "bllokoni" Komisionin/ Përplasje pas aksioneve të SPAK-ut

Berisha, thirrje FBI-së: Nëse Vlorë Hyseni është me Ramën arrestojeni

Masa ndaj Vlorë Hysenit/ Berisha: Shefja e SHISH në shërbim të krimit, nivel i ulët tradhtie


Kush është Vlorë Hyseni, si u emërua në krye të SHISH-it dhe çfarë deklaronte asokohe Rama

[editorial](#)

16:30 Editorial

Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni: Harta e një shteti që po shpërbëhet

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

22:05 Opinione Luan Rama

Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit

21:14 Opinione Filip Çakulli

Tani i Madh, Topi i Madh

10:01 Opinione Ardi Stefa

Patriotët selektivë të patriotizmit selektiv

Lifestyle

14:00 Lifestyle

Ishte shtruar në klinikë rehabilitimi/ Ndërron jetë djali i modeles së njohur

Presley Gerber, djali i supermodeles Cindy Crawford, ka nd...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.